

ETIKA & PËRGJEGJËSIA

MIRËSJELLJA

PËRGJEGJËSIA

ETIKA

KODI I MIRËSJELLES

ADAPTUAR DHE PËRKRAHUR NGA

ANËTARET E

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajdar Dushi C-2, II/8

Prishtinë, Kosovë

+381 (0)38 245 850

info@womensnetwork.org

www.womensnetwork.org

PËRMBAJTJA

- 2 PREAMBULA
- 6 MISIONI & PROGRAMI
- 10 QEVERISJA E MIRË
- 14 RESURSET NJERËZORE
- 18 TRANSPARENCA & PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE
- 22 PËRGJEGJËSIA CIVILE
- 24 PARTNERITETET & RRJETËZIMET
- 25 FUNKSIONIMI I KODIT

Kodi mbi Etikën dhe Përgjegjësitë i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës

© 2007 Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8, Prishtinë, 10000 Kosovë

Lejohet e drejta për ribotim.

PREAMBULA

Kodi i Etikës dhe Përgjegjësisë është dokument i parimeve dhe pikave të referimeve miratuar nga një grup i organizatave joqeveritare (OJQ) anëtare të Rrjetit të Grupit të Grave në Kosovë (RrGGK). Kodi përkrah avancimin e profesionalizmit dhe efektivitetit të anëtarëve të saj, si organizata që punojnë për të mirën publike. Ai gjithashtu siguron një qasje dhe veprim të koordinuar drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në Kosovë.

Në mënyrë që puna e tyre të jetë e suksesshme, anëtarët e RrGGK-së mbështeten në përkrahjen e njëri-tjetrit. Ato, po ashtu, varen nga një organ i shumëllojshëm individësh, fondacionesh dhe organizatash, për ofrimin e përkrahjes morale, teknike, financiare apo të ndonjë lloji tjetër. Prandaj, anëtarët e RrGGK-së duhet të mbajnë marrëdhënie të besueshme, transparente dhe të hapura me publikun si dhe përkrahësit tjerë. Me synim të fuqizimit të përkrahjes dhe besimit publik, anëtarët e RrGGK-së kanë hartuar, miratuar dhe janë pajtuar që të zbatojnë Kodin e Etikës dhe Përgjegjësisë.

Kodi përfshin gjashtë parime themelore: Misionin dhe Programin; Qeverisjen e Mirë; Burimet Njerëzore; Transparencën Financiare dhe Përgjegjshmërinë; Përgjegjësinë Qytetare; Partneritetet dhe Rrjetëzimin. Përparimi i anëtarëve të RrGGK-së drejt përmbushjes së këtyre parimeve matet përmes një varg pikash të referimit, të cilat tregojnë nivelin sipas të cilit organizata përmbush përgjegjësitë e veta para përfituesve e përkrahësve të vet dhe publikut në përgjithësi.

Në vitin 2006, anëtarët e RrGGK-së u zotuan për të përmbushur në tërësi Kodin e Etikës dhe Përgjegjësisë të RrGGK-së deri në dhjetor të vitit 2009. Deri në fund të vitit 2007, anëtarët duhet të përmbushin së paku 50% të Kodit; deri në 2008, 75%; dhe deri më 2009 tërë kodin. Anëtarët e RrGGK-së u pajtuan që të parashtrajnë aplikacion çdo vit, duke treguar mënyrën se si dëshirojnë të përparojnë drejt përmbushjes së kodit.

Sipas vendimit të aprovuar nga anëtarët, RrGGK në mënyrë publike largohet nga anëtarët të cilët dështojnë në përmbushjen e parimeve të kodit për një periudhë prej më shumë se një vit, dhe ato nuk mund të jenë më anëtare të RrGGK-së. Çdo vit, RrGGK nxjerr një listë të re të organizatave të veta për anëtarët, donatorët dhe publikun.

RrGGK përkrah anëtarët e saj në përmbushjen e parimeve dhe pikave të referimit të kodit përmes ofrimit të përkrahjes së vazhdueshme dhe mundësive të trajnimit. Veç kësaj, RrGGK inkurajon OJQ-të joanëtare në Kosovë që të përpiqen të punojnë drejt vlerave të ngjashme të transparencës dhe përgjegjshmërisë në punën e tyre.

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), i formuar në vitin 2000, ishte një rrjet joformal i grupeve të grave dhe organizatave nga regjione të ndryshme të Kosovës. RrGGK u zhvillua në një rrjet që avokon për të drejtat e grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Duke përfaqësuar më shumë se 80 organizata të grave të të gjitha grupeve etnike në Kosovë, RrGGK është një rrjet udhëheqës i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë dhe rajon. Në 2006, RrGGK u bë organizata e parë jo-fitimprurëse dhe jo-qeveritare, që adaptoi kodin e mirësjelljes, duke treguar kështu shembull të transparencës dhe përgjegjësisë.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe të vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga orientimi politik, religjioz, niveli i arsimimit, mosha, orientimi seksual apo aftësitë tjera. Ne përmbushim misionin tonë me anë të këmbimeve të përvojave dhe informatave, partneritetit dhe rrjetëzimeve, avokimeve dhe hulumtimeve.



PSE TË ZBATOHET KODI?

Duke e zbatuar Kodin e Etikës dhe Përgjegjësisë, organizatat joqeveritare mund të zhvillojnë më tutje kapacitetin e tyre organizativ dhe të profesionalizojnë punën e tyre. Pikat e krahasimit të këtij kodi mund të shërbejnë si udhëzime për anëtarët e stafit të organizatave për të vlerësuar më mirë misionin dhe programet e organizatës; për të përmirësuar qeverisjen e organizatave të tyre; për të përkrahur marrëdhënie më të mira të brendshme në mes të stafit dhe vullnetarëve; për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri financiare; dhe për të kërkuar marrëdhënie tjera me pjesëtarët e komunitetit dhe organizatat tjera.

Është shumë me rëndësi që organizatat që pajtohen me këtë kod të tregojnë përkushtimin e tyre për transparencë dhe përgjegjshmëri. Demonstrimi publik i profesionalizmit, efikasitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë do t'i mundësojë organizatat që të sigurojnë besim më të madh publik për punën e tyre. Donatorët aktualë dhe të mundshëm, përfshirë edhe qytetarët, do të inkurajohen që të ofrojnë përkrahjen e tyre për organizatat të cilat janë transparente dhe llogaridhënëse.



Po ashtu, duke zbatuar Kodin e Etikës dhe Përgjegjësisë, organizatat do të bëhen të pranueshme për t'u bërë anëtare të Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës (RrGGK). Anëtarët e RrGGK-së kanë qasje në përfitime dhe shërbime të shumta ...

PSE TË BËHENI ANËTAR I RrGGK-SË?

Së pari, RrGGK ndihmon organizatat anëtare në identifikimin e burimeve të financimit dhe përkrahjes, drejt arritjes së misioneve të organizatave. RrGGK ka themeluar grupe punuese të përbëra nga organizata të specializuara në tri lëmi: përmirësimi i shëndetit të gruas, adresimi i dhunës ndaj gruas dhe trafikimi, dhe rritja e pjesëmarrjes së gruas në politikë. Për disa organizata anëtare të përfshira në të tri programet e rrjetit, RrGGK ka ngritur më shumë se 50,000 Euro të cilat kanë shkuar drejtpërdrejt në organizatat anëtare. Në të ardhmen, RrGGK do të vazhdojë përkushtimin e vet në identifikimin e burimeve për organizatat anëtare me misionet e qarta nga të cilat përfiton publiku.

Së dyti, si rrjet i OJQ-ve që punojnë në trajtimin e çështjeve të ndryshme që ndikojnë te gratë dhe komunitetet në Kosovë, RrGGK ofron forumin për OJQ-të për shkëmbimin e informatave dhe për të mësuar nga përvojat e njëra-tjetrës. Takimet dymujore të ndarjes së informatave, ueb faqja e RrGGK-së me profilet e anëtarëve, raporti vjetor që përmban informatat kontaktuese të anëtarëve dhe buletini informativ tremujor që tregon për aktivitetet e rrjetit dhe të anëtarëve individual janë të gjitha burime informuese të cilat i ofron RrGGK për anëtarët si dhe për palët vendore dhe ato ndërkombëtare me interes në punën e RrGGK-së. RrGGK ka mijëra partnerë dhe përkrahës anëmbanë botës dhe promovon rrjetëzimin në mes të anëtarëve të saj dhe OJQ-ve, partnerëve dhe palëve tjera me interes, si në mënyrë lokale ashtu edhe në atë ndërkombëtare.

Së treti, RrGGK ofron mekanizma përkrahës përmes së cilëve anëtarët me shqetësime të përbashkëta mund të bashkohen shpejtë drejtë një kauze të përbashkët. RrGGK ofron përkrahje të avokimit për organizatat e saja anëtare, duke bashkuar disa organizata anëtare për të shkruar letra të avokimit dhe për të bërë presion, sipas nevojës, në nivelin komunal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. RrGGK mbron vlerat dhe interesat e anëtarëve të saj, duke u ndihmuar atyre me përfaqësimin e interesave të tyre te autoritetet dhe publiku, sipas nevojës.

Së katërti, RrGGK ka krijuar një reputacion për përgjegjshmërinë, transparencën dhe iniciativat e saja të avokimit. Duke u bërë organizatë anëtare, OJQ-të do të njihen si pjesë e këtij rrjeti të respektuar.

Së pesti, në drejtim të përmbushjes së këtij kodi dhe anëtarësisë së fortë e të zhvilluar për nga aspektet organizative, RrGGK ofron shërbime përkrahëse, përfshirë informime, trajnime, mentorime dhe këshillëdhënie profesionale për të ndihmuar anëtarët e veta në kapacitetet e tyre organizative.

& PROGRAMI

Organizatat joqeveritare financohen me qëllim që t'i shërbejnë shoqërisë. Organizatat anëtare të RRGK kanë misione të përcaktuara qartë në aktet e tyre normative dhe si programet dhe veprimtaria e tyre kontribuon në arritjen e këtij misioni. Organizatat rregullisht u ofrojnë mundësi përkrahësve dhe përfituesve të punës së tyre, dhe shoqërisë në përgjithësi, në vlerësimin e misionit, programit dhe veprimtarisë së tyre.

PËRKUFIZIMI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE, JOFITIMPRURËSE

1. Organizata joqeveritare, nuk përkrah asnjë parti politike. Megjithatë, pozita e ndonjë OJQ-je lidhur me ndonjë çështje të caktuar, mund të koincidojë me pozitën e një partie politike lidhur me çështjen e caktuar.
2. Nëse ndonjë anëtar i OJQ-së ka funksion apo pozitë formale në ndonjërin nga partitë politike duhet të japin dorëheqje nga pozita e tyre në OJQ.
3. Organizata, pasi që punon në shërbim të shoqërisë, përfshirë punonjësit dhe anëtarët e bordit, nuk krijon profite nga puna e saj.
4. Organizatat joqeveritare u shërbejnë shoqërisë me punën dhe programet e saj. Ato bazohen në nevojat e njerëzve të cilëve synon t'u shërbejë (përfituesve).
5. Organizata joqeveritare nuk përdor dhe nuk përkrah përdorimin e dhunës apo të çfarëdo lloji të diskriminimit bazuar në racë, etni, religjion, orientim seksual apo moshë.
6. Në OJQ mund të punohet edhe vullnetarisht, prandaj askush nuk mund të detyrohet të punojë pa vullnetin e vet në organizatë.


MISIONI

1. Organizata ka mision dhe objektiv kryesor të përcaktuar qartë, të cilat specifikojnë:
 - Çka synon organizata të arrijë;
 - Veprimtaritë në të cilat është e përfshirë;
 - Mënyrën e realizimit të këtyre veprimtarive; dhe
 - Mënyrën si këto aktivitete i qasen nevojave të përfituesve për të cilat OJQ-të janë themeluar.
2. Misioni duhet të miratohet nga bordi i drejtorëve të organizatës.
3. Për arritjen e misionit, organizata punën e saj e bazon në Statut, rregullore të punës dhe akte tjera normative dhe objektivat e veta.
4. Veprimtaritë e organizatës duhet të jenë plotësisht në pajtim me misionin e saj.



VLERËSIMI I MISIONIT DHE PROGRAMEVE

1. Së paku një herë në pesë vjet, organizata rishqyrton misionin e vet. Në bashkëpunim me punonjësit e vet, bordin dhe përfituesit e përcaktuar, organizata diskuton mbi ndryshimet që duhet kryer në misionin, programet apo veprimtarinë e punës.
2. Në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i përgjegjshëm, organizata miraton Statutin dhe rregulloren përmes të cilave vlerësohet misioni, programet e saja dhe veprimtaria e punës.
3. Në periudha të caktuara dhe jo më pak se një herë në vit, organizata inkurajon stafin, anëtarët, përfituesit, përkrahësit dhe shoqërinë që sinqerisht të vlerësojnë në aspektin kuantitativ dhe cilësor:
 - Nëse programet i kontribuojnë misionit të përcaktuar;
 - Dobishmërinë dhe efektivitetin e veprimtarive të saj;
 - Arsyetimin e shpenzimeve; dhe
 - Rezultatit për përfituesit.Të gjithë vendimmarrësit në mënyrë anonime mund të parashtrojnë ankesa, të cilat do të merren në konsideratë nga organizata.
4. Organizata shqyrton çdo ankesë dhe kërkesë duke dhënë vërejtje ose sugjerime në përmirësimin e punës së organizatës në të ardhmen.



QEVERISJA E MIRË

Organizatat anëtare të RRGK duhet të kenë Bordin e Drejtorëve me anëtarë të zgjedhur, që veprojnë vullnetarisht, të cilët zotohen se do t'i përmbahen misionit të organizatës dhe se do të punojnë në organizatë në mënyrë korrekte, të paanshme dhe me përgjegjësi.

Bordi përcakton misionin e organizatës, harton politikat dhe procedurat e menaxhmentit, duke siguruar që organizata të ketë resurse njerëzore adekuate dhe të afta (me pagesë apo në baza vullnetare), dhe siguron që organizata të ketë resurse financiare në dispozicion për të kryer obligimet e veta. Bordi monitoron menaxhimin e organizatës, si dhe programeve punuese dhe financat.

PËRBËRJA E BORDIT

1. Bordi i Drejtorëve përfshin individë të cilët i zotohen misionit të organizatës dhe kanë përvojë të duhur për të përkrahur organizatën në realizimin e këtij misioni. Bordi ka së paku pesë anëtarë, por mund të ketë shtatë apo më shumë.
2. Gjatë takimit të Bordit, prezent duhet të jenë së paku shumica e thjeshtë e anëtarëve të Bordit.
3. Kohëzgjatja e mandatit të një anëtari të Bordit dhe numri i mandateve të një anëtari të bordit duhet të përcaktohet me rregulloren e organizatës.
4. Anëtarët e Bordit mbrojnë interesat e organizatës.
5. Anëtarët e Bordit nuk kompensohen për shërbimin që kryejnë. Atyre mund t'u kompensohen vetëm për shpenzimet e ndërlidhura drejtpërdrejt me shërbimet që kryejnë në bord, (si për shembull shpenzimet e rrugës për pjesëmarrje në takime, etj.).

PËRGJEGJËSITË E BORDIT

1. Bordi takohet se paku dy herë në vit për të marrë vendime në planifikimin afatshkurtër dhe/ose afatgjatë të organizatës, gjatë të cilit anëtarët e Bordit shqyrtojnë pajtueshmërinë e misionit, definojnë apo riveditinojnë objektivat dhe veprimtaritë e organizatës të cilat do të shpijnë drejt përbushjes së misionit, dhe vlerësojnë progresin e bërë drejt përbushjes së misionit.
2. Bordi sipas nevojës, mblidhet për të vlerësuar progresin e organizatës drejt përbushjes së misionit të vet për të shqyrtuar financat, dhe vlerësuar suksesin e programeve dhe veprimtarinë e organizatës.
3. Bordi përcakton procedurat financiare dhe kadrovike përmes akteve të veta normative.
4. Bordi miraton buxhetin e organizatës një herë në vit dhe pajtueshmërinë e buxhetit me programet e propozuara. Kjo përfshin shqyrtimin e përqindjes së buxhetit të organizatës i cili do të shpenzohet në shpenzime operative, në krahasim me programet dhe veprimtaritë. Bordi sipas nevojës miraton rezultatet e auditimit vjetor.
5. Bordi zgjedh Drejtorin-en e organizatës, përcakton kompensimin material për të, dhe vlerëson punën e Drejtorit-es së paku një herë në vit.

OBLIGIMET E BORDIT

1. Bordi është përgjegjës për përcaktimin e procedurave të veta operacionale.
2. Bordi zgjedh anëtarët e rinj të Bordit.
3. Secili anëtar i Bordit duhet të punojë në sigurimin dhe grumbullimin e fondeve për organizatën, për përkrahjen e programeve të saj dhe çështje tjera sipas nevojës.
4. Sipas Statutit ose rregullores, caktohet pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit në takime, si dhe veprimet që ndërmiren për mos përbushjen e obligimeve apo për mos përbajtjen nga dispozitat e parapara në to.
5. Në takime të bordit mbahet procesverbali, nga secili takim, dhe i njëjti i shpërndahet anëtarëve të Bordit.



NJERËZORE

Si punonjësit me pagesë ashtu edhe ata vullnetarë, duhet të kontribuojnë në avancimin e organizatës për të përmbushur në mënyrë efektive misionin e vet. Për këtë arsye, organizatat anëtare të RRGK kanë rregullore që specifikojnë relacionet e tyre me punonjësit e paguar dhe ata vullnetarë, të cilat përfshijnë parimet dhe standardet për sjelljen e punonjësve të vet.

RREGULLAT E STAFIT

1. Zyra Qendrore dhe Organizatat anëtare të RRGK duhet të kenë rregullore me të cilën qeverisë dhe udhëheq punën, obligimet dhe përgjegjësitë e stafit dhe të vullnetarëve. Kjo rregullore, miratohet nga Bordi i Drejtorëve. Rregullorja përcakton sjelljen dhe të drejtat e stafit, përfshirë:
 - Trajtimin e barabartë;
 - Kushtet e punës;
 - Beneficionet;
 - Pushimet vjetore dhe mjekësore;
 - Vlerësimin;
 - Mbikëqyrjen;
 - Punësimin dhe largimin nga puna;
 - Parashtrimin e ankesave;
 - Ngacmimin seksual;
 - Ngritjen dhe zhvillimin e punonjësve; dhe
 - Besueshmërinë e informatave dhe dosjeve të stafit dhe klientëve të organizatës.
2. Stafi respekton punën drejt përmbushjes të misionit dhe objektivave të organizatës.
3. Sjellja korrekte e stafit kontribuon në zhvillimin e organizatës, përmirësimin e imazhit të OJQ-ve, dhe besimin e shoqërisë tek OJQ-të në përgjithësi. Për këtë arsye, gjatë përfaqësimit të organizatës para punonjësve tjerë, vullnetarëve apo shoqërisë, stafi duhet të silllet në mënyrë profesionale dhe pozitive.
4. Stafi duhet të jetë i sinqertë, të mos mashtrorë gjatë prezantimit të organizatës apo veprimtarive tjera të saj.
5. Stafi nuk mund të kyçet në kritika publike të organizatës. Ata paraqesin kritikën mbi organizatën tek vet organizata dhe përfaqësuesit e saj para se këtë çështje t'ia drejtojnë palëve të jashtme.

VLERËSIMI I STAFIT

1. Pas punësimit, stafi pranon një udhëzim mbi pozitën, obligimet dhe përgjegjësitë që do të ndërmerren si dhe do të informohen mbi misionin, objektivat, programet, veprimtaritë, dhe rregulloren e organizatës, përfshirë edhe Kodin.
2. Organizatat duhet të aprovojnë rregullore për vlerësimin e cilësisë së punës, efektivitetit dhe progresit që kanë arritur punonjësit, vlerësim që bëhet së paku një herë në vit.
3. Punonjësit marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm vjetor të organizatës dhe të vetë punës së tyre drejt përbushjes së misionit të organizatës, ku ata në mënyrë objektive identifikojnë sukseset dhe sfidat e organizatës, marrëdhëniet e tyre me vendimmarrësit dhe publikun duke propozuar mënyra të perfeksionimit në të ardhmen.



VULLNETARËT

1. Organizatat vlerësojnë dhe trajtojnë vullnetarët me respekt. Vullnetarët informohen mbi misionin, objektivat, programet, veprimtaritë dhe rregulloren e organizatës, përfshirë edhe këtë Kod.
2. Organizatat u ofrojnë vullnetarëve trajnime, kushte të mira pune (p.sh. kompjuter, materiale për projektet), duke mbikëqyr punën e tyre sipas nevojës, për të arritur aftësim dhe pjesëmarrjen adekuate të tyre në veprimtaritë e ndryshme.
3. Nëse ekziston interesimi, vullnetarët të cilët posedojnë kualifikim dhe përvojë adekuate, duhet të kenë përparësi ndaj aplikuesve të tjerë gjatë mundësive të punësimit në OJQ.
4. Organizata u jep vullnetarëve certifikata falënderuese dhe rekomandime, si dhe vlerësim për punën dhe përkushtimin e tyre vullnetar ndaj organizatës.



TRANSPARENCA & PËRGJEGJËSIA

OJQ-të duhet t'u përmbahen Ligjeve të Kosovës që janë në fuqi dhe Statutit të organizatës së vet si dhe rregullave që parashtron donatori. Organizatat duhet të kenë një sistem të qëndrueshëm financiar të mbajnë dosje dhe raporte të sakta dhe permanente financiare, duke shfrytëzuar financat për qëllime bamirëse. Sa i përket financave OJQ-të duhet të jenë transparente dhe të hapura ndaj përkrahësve, përfituesve dhe shoqërisë, si dhe kërkesave të donatorëve.

FINANCIARE

PROCEDURAT

1. Organizata ka buxhetin të cilin e aprovon Bordi për çdo vit kalendarik.
2. Organizatat janë të informuara se duhet të punojnë dhe veprojnë në pajtim me të gjitha ligjet e zbatueshme në Kosovë, përfshirë ato të cilat janë të ndërlidhura me regjistrimin, përgjegjësinë financiare, resurset njerëzore, lobimin dhe avokimin politik dhe taksat etj. Organizatat në mënyrë periodike shqyrtojnë pajtueshmërinë e tyre me dispozitat ligjore, raportimin financiar, duke ofruar një arritje të rezultateve për anëtarët e Bordit.
3. Organizatat duhet të kenë politika adekuate financiare në pajtim me kompleksitetin e organizatës, të cilat qeverisin duke pas parasysh mënyrën si investohen pajisjet e organizatës, procedurat e kontrollit të brendshëm dhe praktikrat e blerjes.
4. Organizatat nuk kanë përfitime personale, nuk marrin pjesë në korrupsion, dhënie të mitos, apo keqpërdorime tjera financiare gjatë veprimtarive të veta. Ajo vepron në mënyrë adekuate dhe reagon në rast se ndonjëri nga punonjësit apo anëtarët e Bordit të saj përfshihet në keqpërdorime financiare.
5. Organizatat duhet të krijojnë mundësi që anëtarët e Bordit, stafi dhe vullnetarët të mund të raportojnë në mënyrë anonime keqpërdorimin e financave.

KONFLIKTI I INTERESAVE

1. Organizatat anëtare të RRGK, përfshirë stafin, vullnetarët dhe anëtarët e Bordit të tyre, përmbahen nga konflikti i interesave që do të thotë se ata veprojnë në interesin më të mirë për organizatën.
2. Për të parandaluar konflikte, organizatat kanë rregullore të cilat përfshijnë të gjitha çështjet që mund të konsiderohen si konflikt interesash nga organizata; procedurat për paraqitjen dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave; si dhe hapat përkatës që duhet të merren në rast të paraqitjes së konfliktit të interesave.
3. Organizatat përpilojnë një deklaratë mbi konfliktin e interesave të cilën do t'a shpërndajnë të gjithë anëtarëve të Bordit dhe stafit.

Ç'është Konflikti i Interesave?

Konflikt i interesit konsiderohet kur një anëtar i stafit apo bordit përdor financat e organizatës për përfitim personal, të familjes apo miqve. për shembull, format e konfliktit të interesit përfshijnë: pranimi në punë i një anëtar të familjes që të punojë në OJQ pa procedurë të intervistimit dhe aprovim të bordit; apo angazhimi i shtypshkronjës së anëtarit të familjes që të punojë për OJQ, edhe pse një kompani tjetër kryen punë të kualitetit të njëjtë dhe me çmim më të ulët.

MBLEDHJA E FONDEVE

1. Organizatat pranojnë fonde nga përkrahësit dhe donatorët e tyre. Këto fonde mund të shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe varësisht nga qëllimi apo veprimtaria e cila është propozuar për shfrytëzimin e tyre. Nëse ato nuk shfrytëzohen në mënyrën e përcaktuar nga donatori, organizata obligohet të kthejë fondet apo të kërkojë nga donatori leje për t'i shfrytëzuar fondet në ndonjë mënyrë tjetër.
2. Organizatat nuk lejojnë marrjen e fondeve të dyfishta nga burime të ndryshme për një qëllim apo veprimtari të njëjtë.
3. OJQ-të duhet të synojnë drejt qëndrueshmërisë dhe gjetjes së formave të ndryshme të vetë-financimit për të përkrahur veprimtaritë e tyre. Të hyrat e fituara gjatë vetëfinancimit, të cilat investohen sërisht në veprimtaritë e OJQ-së nuk konsiderohen si profite. Megjithatë, këto fonde duhet të mos paraqesin dyfishime për fonde të dhuruara nga donatorët.
4. Në projekt-propozime dhe materiale promovuese për grumbullimin e fondeve, organizatat prezantojnë misionin, programet, të arriturat e veta dhe paraqesin saktësisht destinacionin e synuar për fondet që i kërkojnë. Nuk lejohen gabimet, ekzagjerimet e fakteve, apo komunikimet të cilat mund të krijojnë bindje të gabuar apo moskuptim.
5. Organizatat nuk mund të bëjnë presion të shtuar mbi donatorët apo donatorët potencial.
6. Organizatat kanë rregullore të cilat specifikojnë se nga cilët individë, biznese, apo organizata do të pranojnë apo jo donacione, si dhe lloje të donacioneve, në pajtim me misionin e vet. Organizata deklaron qartë se nuk do të pranojë donacione nga persona joadekuat apo për veprimtari të cilat janë në kundërshtim me misionin e organizatës.
7. Organizata duhet të monitorojë dhe të jetë e informuar për të gjithë individët apo përfaqësuesit e organizatës të cilët kërkojnë fonde në emër të organizatës.

PËRGJEGJËSIA DHE TRANSPARENCA

1. Organizatat anëtare shqyrtojnë buxhetin dhe shpenzimet e tyre, si dhe përpilojnë raporte të shkruara të cilat ia paraqesin Bordit së paku dy herë në vit. Në këto raporte përshkruhen të gjitha fushat në të cilat shpenzimet kanë ndryshuar nga ajo që është propozuar ose paraparë.
2. Organizatat duhet të jenë profesionale dhe të sakta në menaxhimin e financave dhe të gjithë donatorëve u dorëzojnë raporte narrative dhe financiare.
3. Organizatat duhet të jenë transparente sa i përket buxhetit, duke ia ofruar të gjithë të interesuarve dhe vendimmarrësve (së paku një herë në vit) për shqyrtim.
4. Organizatat periodikisht analizojnë sa është efektive puna dhe veprimtaria e tyre duke i arsyetuar shpenzimet në programet e tyre; ndikimin që ushtrohet tek pjesëmarrësit në relacion me shpenzimet.
5. Gjatë funksionimit të vet, organizata shfrytëzon resurset e veta njerëzore, financiare, materiale dhe me përgjegjësi, duke marr në konsideratë nevojat e gjeneratës aktuale dhe gjeneratave të ardhme.
6. Organizatat, buxheti i të cilave tejkalon shumën e paraparë me ligj, i nënshtrohet një auditimi vjetor nga një auditor i certifikuar, i cili përzgjidhet nga Bordi.



PËRGJEGJËSIA

Organizatat joqeveritare funksionojnë në shërbim të shoqërisë. Ato duhet të jenë transparente dhe përgjegjëse ndaj anëtarëve, përfituesve, përkrahësve dhe shoqërisë në përgjithësi, duke u siguruar atyre informata mbi financat, programet dhe veprimtaritë. Organizatat anëtare të RRGK janë në dijeni se veprimtaritë e tyre kanë ndikim në perceptimin e OJQ-ve nga ana e shoqërisë dhe mbajnë përgjegjësi që të ngrisin nivelin dhe vetëdijen e shoqërisë.

1. Organizatat joqeveritare përcaktojnë qëllimet, vendimet dhe veprimtaritë e veta në mënyrë të pavarur. Këto organizata nuk shfrytëzohen nga asnjë parti politike, institucion publik, apo firmë private për interesa të tyre, të cilat do të vënin në rrezik pavarësinë, autonominë apo aftësinë e tyre për të vepruar në interes shoqërore.
2. Organizatat anëtare të RRGK nuk diskriminojnë asnjë person gjatë punësimit, programeve apo komunikimeve të tyre, në bazë të moshës, racës, kombësisë, etnisë, religjionit, gjinisë, arsimimit, mjeteve financiare, orientimit seksual, apo aftësisë se kufizuar.
3. Organizatat gjatë zbatimit dhe vlerësimit të programeve, projekteve dhe veprimtarisë së punës përfshijnë edhe përfituesit e punës.
4. Organizatat kanë punonjës për qëllime të caktuara, të pajisur me njohuri, të cilët janë përgjegjës për marrëdhëniet dhe komunikimin me publikun dhe të cilët i ofrojnë publikut informata, kurdo që kërkohet.
5. Me qëllim të arritjes së përgjegjësisë dhe transparencës në raport me të gjithë vendimmarrësit, organizata vazhdimisht informon mediat dhe publikun lidhur me veprimtaritë që ndërmerr, përmes konferencave për shtyp, deklaratave për shtyp, njoftimeve, fushatave, publikimeve, seminareve, ueb-faqeve, dhe burimeve të tjera që ka në dispozicion.
6. Gjatë ofrimit të informatave për publikun, organizatat garantojnë se do të ofrojnë informata të mjaftueshme në mënyrë që publiku të kuptojë qartë mesazhin e dërguar. Organizata gjithashtu garanton se të dhënat e paraqitura janë complete, të sakta dhe të vërteta. Organizatat nuk zmadhojnë dhe as nuk zvogëlojnë nevojat njerëzore apo materiale të njerëzve të cilëve u ndihmon, posaçërisht gjatë aktiviteteve të mbledhjes së fondeve.
7. Organizatat u ven në dispozicion të gjithë vendimmarrësve dhe të gjithë të interesuarve një raport në të cilin theksohen të gjitha të dhënat e nevojshme mbi veprimtarinë dhe financat e tyre, së paku një herë në vit. Në këtë raport gjithashtu vendosen emrat e anëtarëve dhe Bordit të organizatës, si dhe të punonjësve të saj.
8. Organizatat i komunikojnë qëllimet e tyre publikisht.



PARTNERITETET DHE RRJETËZIMET

Krijimi i partneriteteve dhe rrjeteve me organizata tjera dhe me trupa tjerë jo-ideologjik paraqet një çështje kyçe për punën e RRGK dhe anëtarëve të saj. Organizatat anëtare të RRGK synojnë të mbajnë raporte profesionale, pozitive dhe të respektimit të ndërsjellë me organizatat tjera, posaçërisht me ato që punojnë me çështje të ngjashme.

1. Gjatë punës së tyre, organizatat anëtare të RRGK veprojnë në mënyrë profesionale dhe i trajtojnë përfituesit dhe partnerët e tyre me respekt.
2. Organizatat duhet të cekin në rregullore se informatat personale të përfituesve gjatë punës së tyre mbesin konfidenciale.
3. Organizatat respektojnë dhe njohin pronësinë e projekteve dhe ideve të individëve dhe organizatave tjera.
4. Organizatat dhe punonjësit e saj kuptojnë se shoqëria civile shquhet me shumëllojshmëri, dhe se organizatat tjera të cilat veprojnë në shoqëri mund të mos pajtohen me misionin e tyre. Edhe në këtë rast, organizatat anëtare do të tentojnë të mbajnë marrëdhënie profesionale punuese dhe të respektojnë të drejtën e organizatave tjera që të kenë pikëpamje të ndryshme. Edhe pse përfaqësues individual të organizatës mund të mos pajtohen, ata nuk do të përgojnë organizatat tjera, pikëpamjet apo punonjësit e tyre.
5. Një organizatë anëtare e RRGK nuk duhet të veprojë dhe punojë në dëm të një organizate tjetër anëtare për të përfituar vetë.
6. Organizatat anëtare do të respektojnë të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e shkruara.

FUNKSIONIMI I KODIT MBI

ETIKËN &

PËRGJEGJËSITË TË RRGK

I. PROCESI I VËRTETIMIT TË ANËTARËSISË

- 1.1. Çdo anëtar i RRGK do ta nënshkruajë Kodin mbi Etikën dhe Përgjegjësitë duke u pajtuar kështu me parimet themelore të tij.
- 1.2. Prej secilit anëtar të RRGK do të kërkohet dorëzimi vjetor i materialeve të kërkuara, të cilat do të dëshmojnë se është punuar në pajtim me Kodin dhe sa janë realizuar etapat e parapara deri me 31 dhjetor të vitit përkatës.
- 1.3. Pas marrjes, stafi i RRGK do të shqyrtojë materialet dhe do të sigurohet se të gjitha materialet e kërkuara janë dorëzuar. Nëse ndodh që mungon ndonjë material, ai ose ajo (punëtorët e RRGK) do ta kontaktojnë organizatën anëtare. Stafi i RRGK do të kompletojë materialet dhe do ti krahasojë ato me listën e kontrollit dhe më pas të njëjtat do t'i dorëzojë në këshill.
- 1.4. Këshilli do t'i shqyrtojë materialet dhe do të vërtetojë (me vota) nëse secili anëtar i ka përbushur kriteret e përcaktuara me Kodin mbi Etikën dhe Përgjegjësitë, për të vazhduar të jetë anëtar i RRGK.
- 1.5. Stafi i RRGK do ti informojë organizatat anëtare se anëtarësia e tyre në RRGK do të vazhdojë dhe ato do të kenë qasje edhe më tej në të gjitha shërbimet si anëtare të RRGK.
- 1.6. Çdo vit kalendarik, të gjitha organizatat anëtare do të marrin listën e organizatave të RRGK.



II. PËRBËRJA E KËSHILLIT

Këshilli do të ketë pesë (5) anëtarë.

- 2.1. Anëtarët e RRGK do të zgjedhin me shumicë votash këshillin e RRGK-së i cili do të funksionojë si organ i cili siguron që secili anëtar i RRGK duhet ti përmbahet rregullave që përmban Kodi.
- 2.2. Këshilli do të përbëhet nga: dy anëtarë të Bordit të RRGK; dhe tre anëtarë që nuk do të jenë të lidhur drejtpërdrejt me RRGK ose anëtar të saj.
- 2.3. Këshilli do të ketë dy pjesëtarë alternativ.
- 2.4. Mandati i anëtarëve të Këshillit do të zgjas dy vite dhe rizgjedhja e të njëjtit pjesëtar të Këshillit mund të bëhet vetëm për dy mandate të ardhshme.



III. FUNKSIONIMI I KËSHILLIT

- 3.1. Këshilli siguron që secili anëtar i RRGK i ka përmbushur kërkesat e parashtruara në Kod.
- 3.2. Këshilli do të marr për bazë ankesat e paraqitura nga stafi, qeveria, donatorët, partnerët, OJQ-të apo nga publiku i gjerë lidhur me mos përmbushjen e kërkesave të parashtruara me Kod nga ana e OJQ-ve.
- 3.3. Këshilli mund të bëjë shqyrtimin dhe rekomandimin e ndryshimeve periodike të Kodit për anëtarët e RRGK.
- 3.4. Këshilli do të përcaktojë rregullat dhe procedurat e punës së tij.
- 3.5. Këshilli do ta caktojë personin udhëheqës, i cili do të ketë detyrat dhe obligimet që dalin nga ky Kod dhe rregulloret tjera.
- 3.6. Këshilli do të shqyrtojë rastet kur nuk zbatohet Kodi dhe do të rekomandojë veprimet që duhet ndërmarr nga ana e RRGK.
- 3.7. Pjesëtari i Këshillit i cili ka ndonjë interes personal apo profesional në ndonjë nga rastet e paraqitura, nuk i lejohet të marr pjesë në marrjen e vendimit lidhur me atë rast. Në rast të tillë një prej anëtarëve alternativ të Këshillit do të thirret të merr pjesë në atë proces vendimmarrës.

IV. PARAQITJA E ANKESAVE

- 4.1. Secili person apo grup, mund të parashtrojë ankesë lidhur me atë se si ndonjë anëtar i RRGK nuk i është përmbajtur rregullave të Kodit. Ankesa do t'i dorëzohet udhëheqësit të Këshillit.
- 4.2. Një ankesë e shkruar duhet të përmbajë:
 - Emrin dhe adresën e ankuesit.
 - Emrin dhe adresën e OJQ-së ose zyrtarit kundër kujt paraqitet kjo ankesë.
 - Rrethanat në të cilat ka ndodhur ose supozohet të ketë ndodhur shkelja e rregullave të Kodit.
 - Faktet që përkrahin këtë ankesë.
- 4.3. Udhëheqësi i Këshillit do të sjell para Këshillit këtë ankesë në takimin e ardhshëm, pas prezantimit të fakteve nga ankesa.
- 4.4. Anonimiteti i ankuesit do të ruhet, sipas kërkesës së tij.



V. PROCESI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

- 5.1. Këshilli do të informojë organizatën për të cilën është paraqitur ankesa dhe e njëjta do të ketë mundësi të përgjigjet ndaj akuzave të parashtruara.
- 5.2. Këshilli mund të kërkojë nga secili përfaqësues i OJQ-së në fjalë, të ofrojë të dhëna të sakta dhe plotësuese lidhur me rastin që shqyrtohet.
- 5.3. Informata do të mbahet si konfidenciale deri në masën që nuk e pengon hetimin e rastit.
- 5.4. Këshilli mund të thërras takim mes akuzuesit dhe OJQ-së së akuzuar për të sqaruar rastin, nëse është e domosdoshme dhe nëse palët pajtohen.
- 5.5. Këshilli me shumicë votash do të vendosë se si do të procedojë me rastin në fjalë.
- 5.6. Nëse vërtetohet se ndonjë anëtar i RRGK apo ndonjë punëtor i OJQ-ve anëtare të RRGK kanë shkelur rregullat e Kodit, masat e poshtë përmendura mund të ndërmerren:
 - 1) Përfshirja e RRGK në ofrimin e edukimit të duhur për OJQ, në mënyrë që e njëjta të mund ti përmbahet rregullave të Kodit;
 - 2) Këshillon OJQ në fjalë që të merr masa të duhura kundër punëtorëve të OJQ-së të cilët janë drejtpërdrejt përgjegjës për thyerjen e Kodit;
 - 3) Tërheq vëmendjen e OJQ-së dhe i jep të njëjtës kohë të caktuar gjatë së cilës do të kenë mundësi ta korrigjojnë thyerjen e Kodit;
 - 4) Rekomandon suspendimin ose largimin e plotë të organizatës anëtare nga të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e RRGK-së.
- 5.7. Organizata ka të drejtë të paraqitet para Këshillit shpjegimet dhe faktet e veta përpara se të suspendohet apo largohet nga RRGK.
- 5.8. Udhëheqësja/i i Këshillit do ta informojë OJQ-në dhe ankuesin për vendimin që është marr.

VI. ANKESA NDAJ VENDIMIT

- 6.1. Një anëtar mund të ankohet ndaj vendimit të Këshillit duke iu drejtuar me ankesë me shkrim RRGK-së brenda afatit prej një muaji prej marrjes së vendimit. Në ankesë jepen shpjegime dhe fakte të duhura duke kundërshtuar vendimin. RRGK do ta paraqes këtë ankesë para anëtarësisë së vet në mbledhjen e ardhshme dymujore, ku anëtarët e RRGK do të votojnë lidhur me rastin. Pas dëgjimit të rastit dhe prezantimit të provave anëtarët e RRGK mundën me shumicë votash të:
 - Të rikthej rastin përsëri në Këshill për rishqyrtim duke marrë parasysh edhe fakte të tjera shtesë.
 - Të konfirmoj vendimin e Këshillit.
 - Të ndryshoj vendimin e Këshillit.
 - 6.2. Ankesa pas kalimit të afatit të paraparë në Kod, nga marrja e vendimit nuk do të pranohet, përveç në rastin kur pala dëshmon ekzistimin e arsyeve të mëdha për kalimin e afatit prej një muaji.
 - 6.3. Organizatat që janë larguar nga Rrjeti pas një procesi të tillë, duhet të presin të paktën dy vite para se të fitojnë të drejtën të aplikojnë sërish për anëtar të RRGK, në të cilën kohë OJQ-ja në fjalë duhet të dëshmojë se i është përmbajtur rregullave të parashtruara me Kod.
- Kodi mund të ndryshohet pas aprovimit nga 2\3 e anëtarëve të Këshillit dhe Bordit të RRGK si dhe pas informimit paraprak të anëtarëve të RRGK.





Për më shumë informata mbi *Kodin e Etikës dhe Përgjegjësi* të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), ose për tu anëtarësuar në RrGGK, ju lutem na kontaktoni në:



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajdar Dushi C-2, II/8

Prishtinë, Kosovë

+381 (0)38 245 850

info@womensnetwork.org

www.womensnetwork.org

**Dizajnuar nga
Nicole Farnsworth**

**Financuar nga
Rockefeller Brothers Fund**